

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

17.12.2020

Ora 17:33

**RENDI I DITËS**

*Projektvendimi “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet**

**2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, O.Peto, E.Gaxholli**

**Përfaqësues të partive politike:**

**1.PD (z.I.Kaso)**

**2.LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Mirëmbërëma, unë mendoj që të fillojmë, nuk besoj se do t'i bashkohen të tjerë përfaqësues të partive politike kësaj mbledhje, por edhe nqs është rasti i kanë të gjitha mundësitë teknike për t'iu bashkuar kësaj seance. Atëherë, sikurse ju kemi bërë me dije në këtë seancë publike të shqyrtimit dhe miratimit të akteve të Komisionerit Shtetëror për Zgjedhjet kemi në rend dite katër çështje. Çështja e parë ka të bëjë me miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

Pika e dytë, me miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021.

Pika e tretë ka të bëjë me miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KRIK për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

Pika e katërt për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021.

Atëherë në qoftë se nuk kemi ndonjë diskutim paraprak nga përfaqësuesit e partive politike, do të propozoja që të vazhdonim me rendin e ditës. Nuk e di nëse zoti Kaso, apo zoti Kazia?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Jo i nderuar, jam dakord me diskutimin e çështjeve që janë në rendin e ditës, nuk kemi gjë jashtë rendit të ditës.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Edhe unë jam dakord zoti Celibashi.

**Z.I.Celibashi:** Ju faleminderit, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e modelit dhe specifikimeve të kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore që do të përdoren në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Ky akt është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në pikëpamje teknike që do të kenë kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve zgjedhore, vlen të evidentohet fakti që janë të njejtat modele kuti votimi dhe kuti të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

materialeve zgjedhore sikurse janë përdorur dhe në zgjedhjet e shkuara. Që prej vitit 2009, nëse nuk gaboj, është i njejtë model kutie votimi dhe kutie materialesh zgjedhore që janë përdorur. Specifikimet teknike secili prej jush por dhe të tjerë të interesuar për këtë projektakt janë bërë të ditura. Unë nuk po zgjatem për ju fjala, përfaqësues të partive politike në qoftë se keni ndonjë koment, diskutim. Zoti Kaso dhe më tej zoti Kazia.

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit zoti Celibashi, jam dakord me projektaktin. Kutitë që janë përdorur si ato të fletëve të votimit dhe kutive të materialeve i plotësojnë kriteret dhe në zgjedhjet e fundit nuk kanë shfaqur probleme. E para, për sa i përket kapacitetit të tyre dhe së dyti për sa i përket rezistencës dhe për pjesën e transportit që mund të ishte delikate. Janë provuar në më shumë se një palë zgjedhje që janë të sigurta dhe të dobishme. Një merak kisha unë por që besoj do të zgjidhet me aktet e ardhshme. Duke qenë se rregulli që miratojmë është rregull i përgjithshëm që këto do të jenë kutitë që do të përdoren në të gjitha qendrat e votimit. Në rast të futjes të sistemit të projektit pilot të votimit dhe numërimit elektronik, shpresoj të arrihet pasi është një proces kompleks dhe ai, që paraqet një sërë sfidash, por duke e konsideruar të mirëqenë që sfidat e teknologjisë me vullnet të mirë dhe me përpjekje të cilat KQZ-së nuk i mungojnë, mund të tejkalohen dhe të jetë i përdorshëm në një numër të caktuar qendrash votimi. Në një ose disa zona zgjedhore, pra qarqe do të na duhet që në atë vendimmarrje le të bëjnë përjashtim le të themi nga ky rregull i përgjithshëm. Ose ta lemë rregullin e përgjithshëm që miratuam sot si residual. Në qoftë se teknologjia shfaq probleme dhe shihet e nevojshme që të kalohet tek sistemi i vjetër që është gjithmonë back-up e ka parashikuar ligji kur teknologjia nuk

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

funksionon. Ndoshta nuk është vendi që të futet në këtë lloj vendimi, po ta kemi si një pikë kujtese kur të miratojmë aktet e tjera për të bërë përjashtimin nga ky rregull i përgjithshëm, faleminderit.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit zoti Kaso, bëtë mirë që e sollët në vëmendje në këtë moment për të sqaruar se miratimi i këtij projektakti nuk ka të bëjë aspak me përdorshmërinë dhe procedurat e përdorjes së këtyre kutive të votimit. Jemi thjesht dhe vetëm duke miratuar çfarë karakteristikash teknike do të kenë kutitë e votimit në ato zona zgjedhore ku do të përdoren si kur se ju e thatë. KQZ-ja është e angazhuar që në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor të fusë në formatin pilot votimin dhe numërimin elektronik gjë që eventualisht nuk do të ketë nevojë për vendosjen e kutive të votimit në qendrat e votimit të këtyre zonave zgjedhore. Kur të jetë rasti që të miratojmë aktin përkatës për mënyrën e futjes së këtij projekti, ndoshta do të lindë nevoja që për situata përjashtimore do të na duhet që të përdoren dhe kutitë e votimit. Kështu që edhe në kuptim të sasisë së kutive të votimit që ne do të porosisim do të përfshijë ky numër të gjitha qendrat e votimit, por domosdoshmërisht kjo nuk do të thotë që është i përjashtuar angazhimi i KQZ-së për të futur projektin mbi votimin dhe numërimin elektronik, faleminderi! Zoti Kazia?!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Jam dakord me miratimin e modelit dhe specifikave të kutive të votimit me përmbajtjen e aktit. Nuk kam ndonjë shtesë, apo kundërshtim.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Meqenëse për projektin që kemi praqitur nuk ka propozime për ndryshim, e miratojmë projektaktin ashtu siç ai është propozuar dhe do të bëhet publikimi i tij në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.

**Vendimi nr.36**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

17.12.2020

Ora 17:40

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet**

**2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, O.Peto, E.Gaxholli**

**Përfaqësues të partive politike:**

**1.PD (z.I.Kaso)**

**2.LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e modeleve të dokumentacionit të punës të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta miratuar. Mendoj që KQZ tani ka krijuar një traditë të konsoliduar prej shumë vitesh në lidhje qoftë me formën, qoftë me përmbajtjen e dokumentacionit të punës së KZAZ-ve. Në përgjithësi kemi ruajtur të njejtat modele të këtij dokumentacioni. Kjo dhe për faktin se në pjesën më të madhe komisionerët janë të familjarizuar tashmë me këtë loj dokumentacioni. Kemi bërë disa përmirësime të cilat kryesisht konsistojnë në formë të këtij dokumentacioni.

**Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

Kemi ndryshuar sistemin e numërtimit të këtij dokumentacioni, të modeleve duke aplikuar një sistem unik të numërtimit të tyre, duke evituar kështu, të paktën në mendimin tonë, atë konfuzion që mund të jetë krijuar në lidhje me numërtimin e modeleve të këtij dokumentacioni, i cili në përmasat e vet ka pas një numër me shkronja dhe nuk ka pas një sistem të unifikuar. Tani e kemi thjeshtuar dhe unifikuar sistemin e numërtimit të modeleve duke filluar nga numri 1 e kështu me rradhë. Nga ana tjetër, për të lehtësuar punën qoftë të KZAZ-së, qoftë të KQV-ve kur të jetë rasti ne kemi përdorur sistemin e kodimit sipas ngjyrave. Dokumentacioni, modelet që do të përdorë KZAZ do të kenë një ngjyrë tjetër, do të kenë një kod me një ngjyrë të caktuar i cili do të jetë i ndryshëm nga kodi i ngjyrës që do të përdoret për modelet që do të përdorë KQV. Kjo do ta bëjë më të lehtë qoftë për ne si administratë e KQZ-së që merret me përgatitjen e materialeve zgjedhore dhe logjistikës zgjedhore në përgjithësi, por dhe për vetë komisionet e niveleve të dyta dhe të treta. Kjo bazohet dhe në eksperiencat e vendeve të tjera ku ka rezultuar që ka qenë mjaft ndihmues edhe ky element teknik i dokumentacionit të niveleve të dyta dhe të treta. Nuk e di nëse përfaqësuesit e partive politike në qoftë se kanë ndonjë diskutim në lidhje me këtë projektakt?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit zoti Celibashi, dy komente të shkurtëra kisha unë në lidhje me projektaktin. Është e vërtetë ajo që thatë ju që KQZ-ja ka një traditë tashmë të konsoliduar për sa i përket këtij lloji akti dhe këtij lloji dokumentacioni që miratohet modeli. Në përmbajtje përgjithësisht është i njëjtë. Sigurisht koha dhe eksperiencia bëjnë të nevojshme dhe perfeksionimet e herë pas hershme të këtij dokumentacioni gjë të cilën ju e keni bërë, e keni propozuar. Veçanërisht e vlefshme besoj do të jetë kodifikimi sipas

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

ngjyrave që i keni bërë dokumentacionit që përdorin komisionet e niveleve të ndryshme, pra KZAZ-ja në një ngjyërë, KQV-ja në një ngjyërë tjetër. Besoj se do të jetë goxha ndihmuese. Do të kërkoja që ky dokumentacion, kjo vendimmarrje menjëherë sa të miratohet sot, të bëhet menjëherë pjesë e manualeve të trajnimit. E konsideroj të domosdoshme le të themi përfshirjen dhe ritheksimin e kësaj pjese në manualet e trajnimit që ju do të miratoni për komisionet e të gjitha niveleve, për shkak se ka ndryshuar dhe sistemi i numërtimit. Nga një anë e bën më të thjeshtë duke i dhënë numër unik çdo lloj dokumentacioni, por duke marrë në konsideratë që një pjesë e mirë e komisionerëve të zgjedhjeve tashmë janë veteranë dhe janë mësuar. Një pjesë të kodeve dhe emërtimeve të vjetra i kemi mësuar edhe ne përmendësh. Psh, fjala vjen kur kërkohej procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit, kërkohej PV KQV 08 nqs nuk gabo. E kam fjalën që pjesa më e madhe janë mësuar me atë lloj numërtimi dhe do të jetë e nevojshme që të theksohet fort kjo pjesë tek trajnimi në mënyrë që të asimilohet sa më shpejt. Këtë kisha si merak. Një gjë tjetër që ma zuri syri por që besoj që është e rikuperueshme. Pashë këtë zarfi “votat parapëlqyese për kandidatët”. Pra, në pjesën e numërimit, tek dokumentacioni që do të përdorë GNV, pasi të numërohen e të vendosen në blloqe thotë “votat parapëlqyese për kandidatët”, risi kjo që përdoret për herë të parë. Kur të mbyllet në kutinë e materialeve do të mbyllen brenda këtyre zarfeve. Tradita ka qenë që votat e vlefshme, pra që futen në zarfin e “vota të vlefshme” që ju e keni parashikuar, grupoheshin sipas partive politike. Çdo parti politike kishte zarfin e vet, ndërkohë që në modelet e miratuara nga ana juaj pashë zarfin e “votave të vlefshme” dhe zarfin e “votave parapëlqyese për kandidatët”. Ndoshta kishte dhe zarfe të tjera të thjeshtë që përdorte ky komision. Ndoshta do të ishte e nevojshme që të parashikohej dhe zarfi i “votave të subjekteve”. Psh në Tiranë që sipas

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

ndarjes së mandateve që miratoi KQZ-ja janë 36 subjekte. Për “x” kandidat po që dhe ata vetë janë subjekte zgjedhore për “x” koalicione, ose subjekte zgjedhore të mos e fragmentojmë shumë dhe procesin e grumbullimit të tyre, por le të themi që një subjekt politik pavarësisht se brenda do t’i ketë të ndara. Në zarfën e “votave të vlefshme” do të ketë zarfën e “votave për secilin kandidat”, përsëri të jenë të grupuara për lehtësi dhe të gjetjes dhe adminsitrimin të mëpasshëm të shtohet dhe zarfi i “votave të vlefshme të subjektit politik”. Pra, kjo hallka e ndërmjetme që ose nuk është parashikuar dmth në dokumentacionin që pashë unë, ose mua nuk ma ka zënë syri. Gjithësesi do të sugjeroja që të përfshihet dhe kjo pjesë.


**Z.I.Celibashi:** Atëhere, në qoftë se ju kuptova drejt, ideja ka të bëjë me këtë që pavarësisht se do të kemi zarfat me “votat për kandidatët parapëlqyes” të ketë dhe një zarf që i përfshin të gjitha votat e subjektit...

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Në moment kontestimi, fjala vjen sepse lidhet dhe me pjesën kontestuese.

**Z.I.Celibashi:** Të gjitha votat e subjektit në kuptimin se mund të kemi dhe raste të tilla, kjo do të mbetet për t’u diskutuar...

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Kodi e parashikon në fakt që votë e vlefshme është dhe ajo që jepet vetëm për subjektin dhe jo për kandidatin, por dhe në rastin se shprehet vota dhe për subjektin dhe për kandidatin, ajo është votë për të dy. Në një moment kontestimi për sa i përket subjektit që i takon mandati, jo për

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

të arritur tek kandidati. Në këtë moment do të jetë e nevojshme të rimerren dhe të evidentohen votat ekzakte që ka marrë një subjekt në një qendër votimi të caktuar, ose në një KZAZ të caktuar është më e lehtë që të mblidhen nëpërmjet këtij zarfi dhe jo të kërkohet manualisht ose sipas emrit që secili kandidat ka përfaqësuar këtë subjekt e të mblidhen të gjithë zarfat e kandidatëve. Kjo për lehtësi grupimi.

**Z.I.Celibashi:** Pra dhe njëherë për ta përmbledhur, në një zarf model që do ta përcaktojmë të jenë votat për subjektin, partinë, koalicionin sipas rastit dhe po në këtë zarf të jenë dhe votat parapëlqyese për çdo kandidat, të futen dhe zarfet e tjerë. Mendoj se është me vend ky sugjerim. Po zoti Kazia!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Jam dakord me sugjerimin e zotit Kaso për sa i takon aktit, projektvendimit. Risia e sjellë nga ana juaj është e mirëpritur nga ana e subjektit tonë edhe për shkak të administrimit të mirë të atij procesi i cili është një proces shumë i rëndësishëm. Nuk kam ndonjë shtesë, apo kërkesë të veçantë.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Duke e pranuar propozimin e paraqitur nga zoti Kaso, e miratoj projektaktin bashkë me këtë shtesën. Pra, krahas modeleve të propozuara në projektakt, do të shtohet dhe një model i ri i zarfit në të cilin do të futen votat e vlefshme për partinë/ose koalicionin sipas rastit dhe votat parapëlqyese për secilin kandidat të partisë, apo koalicionit përkatës. Besoj se jemi korrekt kështu zoti Kaso?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Po!

**Z.I.Celibashi:** Mirë faleminderit!

**Vendimi nr.37**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

17.12.2020

Ora 17:53

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet**

**2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, O.Peto, E.Gaxholli**

**Përfaqësues të partive politike:**

**1.PD (z.I.Kaso)**

**2.LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore në zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 prill 2021”. Edhe ky akt është në kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për ta miratuar. Eksperiencia e zgjedhjeve në Shqipëri njeh faktin që komisionerët e niveleve të dyta dhe të treta, pra anëtarët e KZAZ-ve dhe të KQV-ve, përfitojnë një masë shpërblimi për angazhimet që ata marrin në raport me procesin zgjedhor. Pa diskutim që askush prej nesh nuk mundet me siguri të plotë të thotë që niveli i këtij shpërblimi e justifikon kohën, stresin dhe angazhimin e gjithsecilit prej tyre në këtë proces. Gjithësesi në vlerësimin dhe gjykimin tonë për ta përafuar sa më shumë në raportin e drejtë të angazhimit me shpërblimin, kemi propozuar që për këto

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

zgjedhje të kemi një rritje të masës së ahpërblimit për anëtarët e KZAZ-ve dhe të KQV-ve. Kjo dhe për faktin se prej disa edicioneve zgjedhore niveli i shpërblimit të anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve ka qenë i pandryshuar. Ndërkohë që standartet e konsumit nuk janë ato të viteve të shkuara por janë rritur kostot në këtë kuptim. Padyshim që jemi të vetëdijshëm dhe për situatën ekonomike dhe financiare në të cilën kalon vendi për shkak të komplikimeve që kanë ardhur qoftë prej fatkeqësisë së tërmetit, por dhe të pandemisë. Në këtë kontekst shtesa që kemi propozuar mendoj se justifikon nga njëra anë angazhimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe të KQV-ve, por nga ana tjetër konsideron dhe rrethanat e kushteve ekonomike-financiare të vendit. Konkretisht kemi propozuar:

- a) Për Kryetarin dhe zv.kryetarin e KZAZ-së në vlerën 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.
- b) Për sekretarin e KZAZ-së në vlerën 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë.
- c) Për anëtarin e KZAZ-së në vlerën 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
- ç) Për kryetarin e KQV-së në vlerën 5.000 (pesëmijë) lekë.
- d) Për sekretarin e KQV-së në vlerën 4.500 (katërmijë e pesëqind) lekë.
- dh) Për anëtarin e KQV-së në vlerën 4.000 (katërmijë) lekë.
- e) Për anëtarin e GNV-së në vlerën 10.000 (dhjetëmijë) lekë.

Përfaqësuesit e partive politike në qoftë se kanë ndonjë diskutim në lidhje me këtë projektakt?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Faleminderit dakord me projektaktin. Për të përshëndetur fakti që ka një rritje të masës së shpërblimit për të gjitha nivelet e përfaqësimit të komisionerëve. Sigurisht që asnjëri prej tyre nuk e merr atë angazhim thjesht për të përfituar shpërblimin financiar. Jemi të

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

vetëdijshëm që është i pakrahësueshëm kontributi, koha dhe angazhimi që japin në raport me vlerën financiare që përfiton, por sigurisht që dhe kjo është një pjesë e rëndësishme e vlerësimit që shteti nëpërmjet KQZ-së i bën kontributit të tyre. Kontribut që për hir të së vërtetës kryhet në kushte aspak të lehta dhe aspak komode për sa i përket përgjegjësisë së detyrës që ata ushtrojnë. Gjithashtu dhe për kushtet dhe rrethanat specifike sidomos në zona të caktuara që tensioni, presioni i procesit zgjedhor, apo të numërimit duke konsideruar dhe faktorë të tjerë të jashtëm që ushtrojnë ndikim dhe presion mbi procesin zgjedhor që s'është aspak i lehtë për t'u përballuar. Sigurisht mundësitë financiare këto janë dhe nuk janë të pafundme që kompensimi të ishte në një masë ndoshta dhe më të drejtë, por për të përshëndetur hapi që KQZ-ja ka marrë me rritjen e masës së shpërblimit të tyre. Kështu që jemi dakord me aktin, e mbështesim.

**Z.I.Celibashi:** Po zoti Kazia!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Faleminderit zoti Kryetar. Unë e njoh procesin e administrimit zgjedhor nga brenda. Kam qenë pjesë e procesit prej shumë kohësh. E vlerësoj këtë rritje të bërë nga ana juaj dhe realisht duhet të shihet me pjesën e angazhimit që tha dhe zoti Kaso, me pjesën e përgjegjshmërisë të atyre që do të merren me administrimin zgjedhor. Është një detyrë jo e lehtë për ta. Angazhimi do të jetë maksimal. Angazhimi dhe në kohë është me shumë përgjegjshmëri të lartë, kështu që mirë se të vijnë.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Meqenëse nuk kemi propozime të këtij projektakti e miratoj projektaktin sipas asaj përmbajtje që u është prezantuar ju dhe të tjerëve.

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

Ky projektakt do të publikohet në faqen e internetit të KQZ-së. Këto ishin çështjet që kishim për shqyrtim në rendin e ditës. Meqenëse të gjitha pikat e rendit të ditës u shqyrtuan dhe u miratuan dua t'u falenderoj. Falenderoj përfaqësuesit e partive politike, falenderoj përfaqësuesin e Organizatës KRIIK, falenderoj gjithahstu dhe përfaqësuesit anëtarë të administratës së KQZ-së për punën cilësore të bërë në lidhje me përgatitjen e projektakteve, faleminderit dhe natën e mirë!

**Vendimi nr.38**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

17.12.2020

Ora 17:51

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KRIIK për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

**1.Z.Illirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet**

**2.Stafi i KQZ: Z.Y.Merkaj, znj.E. Jorgaqi, znj.A.Tenolli, O.Peto, E.Gaxholli**

**Përfaqësues të partive politike:**

**1.PD (z.I.Kaso)**

**2.LSI (z.A.Kazia)**

**Z.I.Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KRIIK për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021”. Nuk e di nëse kemi ndonjë përfaqësues nga organizata? Njoftimi është bërë, nuk kemi me sa duket. Përfaqësuesit e partive politike janë njohur dhe me këtë projektakt, në qoftë se kanë ndonjë diskutim në lidhje me këtë projektakt?

**Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike:** Dakord jemi zoti Celibashi me projektaktin e propozuar. Nuk kisha dyshim që organizata KRIIK si një nga partneret më të vjetra të KQZ-së dhe të monitorimit të zgjedhjeve, do të ishte nga të parat që do të bënte kërkesë për akreditim. Besoj se çdo organizatë serioze që

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

kërkon akreditim për vëzhguesit e saj për të monitoruar procesin zgjedhor është një vlerë e shtuar për sa i përket procesit, jemi plotësisht dakord.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Zoti Kazia!

**Z.A.Kazia, përfaqësues i Lëvizja Socialiste për Integrim:** Nuk kemi ndonjë kundërshtim, mirëpresim çdo organizatë që kërkon të ketë vëzhguesit e vet në kuadër të transparencës. I bën mirë procesit, i bën mirë Shqipërisë në këtë rast.

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Unë gjej rastin ta përsëris shpejtësinë me të cilën organizata KRIIK, tashmë me një eksperiencë të konsoliduar në vëzhgimin e zgjedhjeve ka filluar të bëjë detyrën e vet në një lloj mënyre. Është interesi im si institucion, por në përgjithësi dhe interesi i të gjithë shoqërisë, që vëzhgues të organizatave të ndryshme të jenë në proces vëzhgimi për të gjithë aspektet e procesit përgatitor zgjedhor të zgjedhjeve të ardhshme duke filluar që nga dita e parë e përgatitjes së këtyre zgjedhjeve, pasi kjo është një gjë e shëndetshme sepse i shërben transparencës së procesit. Atëherë e miratoj edhe projektaktin që ka të bëjë me miratimin e vëzhguesve afatgjatë të KRIIK për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 Prill 2021, sipas listës që i bashkëngjitet këtij projektakti. Shoh që i është bashkuar kësaj seance përfaqësuesi i organizatës KRIIK zoti Dritan Taulla.

**Z.Dritan Taulla, përfaqësues i KRIIK:** Kërkoj ndjesë që u shkëputa më parë, por u shkëput interneti, ndjesë!

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.17.12.2020*

**Z.I.Celibashi:** Faleminderit! Gjithësesi për dijeninë tuaj kërkesa juaj për akreditimin e 28 vëzhguesve afatgjatë u pranua nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe pa dyshim, natyrshëm që do të pranohej. Vlerësuam unë si Komisioner Shtetëror si dhe përfaqësuesit e partive politike, rolin që organizata juaj ka luajtur në procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve. Eksperienca e saj është një garanci për cilësinë e vëzhgimit dhe për raportin eventual të vëzhgimit të këtyre zgjedhjeve. Gjej rastin t'u falenderoj në emër të KQZ-së që keni marrë angazhimin herët për të bërë detyrën tuaj, nëse mund ta përkufizoj kështu për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe meriton vlerësimin tonë. Edhe përfaqësuesit e partive politike shprehën të gjithë vlerësimin për angazhimin e organizatës tuaj por dhe të organizatave të tjera kur të jetë rasti për të qenë pjesë e vëzhgimit të zgjedhjeve. Kështu që ju falenderoj dhe njëherë.

**Vendimi nr.39**

*Zbardhi materialin e inçizuar  
Stenografia  
Merita DULAKU*

